

PROGRAMET KOMPJUTERIKE PËR GJUHËN SHQIPE

EMIL LAFE¹ dhe LULËZIM SHISHANI²

1. Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, Shqipëri

2. QEP, Prishtinë, Kosovë

E-mail: encikloped@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Gjuha shqipe ka tashmë një program për korrigjimin automatik drejtshkrimor ose "Spell-checker", që është punuar nga Qendra për Edukim dhe Përparim (QEP, Prishtinë) në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë (Tiranë) dhe Institutin Albanologjik të Prishtinës. Në këto pak vite të përdorimit të këtij programi, është ndier dobia e madhe e tij. Tashmë për gjithçka që shkruhet me kompjuter, dhe sot pothuajse gjithçka që shkon për botim kalon nëpër kompjuter, sigurohet një kontroll drejtshkrimor i përshtatshëm që mënjanon gabimet drejtshkrimore gabimet në format gramatikore të fjalëve. Këto gabime mund të vijnë ose nga njohja e pamjaftueshme e drejtshkrimit (p.sh. kur shkruhet *qëndër* në vend të *qendër*) ose nga shpejtësia e shkrimit (kur shtypet një tast në vend të një tjetri, p.sh. *posha* në vend të *pisha*; kur nuk shtypet fare një tast, p.sh. *qyeti* në vend të *qyteti* etj.). Në të dyja rastet programi vepron duke bërë automatikisht korrigjimin e nevojshëm ose duke nënvizuar me të kuqe formën e gabuar. Për të gjitha të mirat, por edhe për mangësitë e pashmangshme, të paktën tani për tani, do të flitet në kumtesë. Krahas kësaj do të paraqiten edhe punët e tjera të QEP në fushën e ndërtimit të programeve kompjuterike për gjuhën shqipe.

Fjalët kyçe: *Gjuha shqipe, program kompjuterik,*

korrigjimin automatik drejtshkrimor, Qendra për Edukim dhe Përparim, Instituti e Gjuhësisë dhe të Letërsisë (Tiranë), Instituti Albanologjik i Prishtinës.

Key words: *Albanian language, computer program, automatic orthographic correction, Center for Education and Development, Institute of Linguistics and Literature (Tirana), Institute of Albanology of Prishtina.*

Në rrethanat e sotme të zhvillimit shoqëror e hapësinor të botës shqiptare gjuhësia kompjuterike dhe programet kompjuterike për gjuhën kanë një rol të dorës së parë për zotërimin dhe zbatimin e normës letrare, për ngritjen e kulturës së gjuhës në masën e gjerë të përdoruesve aktivë të ligjërim-it të shkruar dhe për begatimin e gjuhës shqipe, në mënyrë që ajo të arrijë një përputhshmëri sa më të lartë me gjuhë të tjera në fushat e qarkullimit ndërkombëtar të dijes.

Falë nismës së Qendrës për Edukim dhe Përparim (QEP) në Prishtinë dhe bashkëpunimit të saj me një grup gjuhëtarësh nga institucionet shkencore të Tiranës e të Prishtinës, sot gjuha shqipe përfshihet në numrin e gjuhëve me programe kompjuterike bashkëkohore, që tashmë kanë gjetur zbatim. Ato kanë sjellë, në radhë të parë, një lehtësim jashtëzakonisht të madh të

punës së mundimshme për korrektimin (ose lekturimin, siç thuhet në Kosovë) të gjithë llojeve të botimeve dhe një ulje të rreptë të numrit të gabimeve drejtshkrimore e të formave gramatikore. Dobinë e tyre e kanë ndier të gjithë përdoruesit, që janë shprehur me entuziazëm për vlerat praktike të tyre.

Kushdo që e ka pak a shumë idenë e krijimit të një programi gjuhësor kompjuterik, e di se sa punë e mundimshme dhe e vëllimshme kërkohet për ta ndërtuar atë, por, siç thuhet, “ia vlen barra qiranë”, këto programe janë domosdoshmëri. Ndërtimi i tyre, nga ana tjetër, është bërë i mundshëm edhe për faktin se gjuha shqipe ka tashmë një normë drejtshkrimore e leksikore të konsoliduar, çka është fryt i lëvrimit të saj dhe i punës së kujdesshme shkencore të gjuhësisë shqiptare.

Po japim një paraqitje shumë të shkurtër të programeve të realizuara, meqenëse ato, për shkak të një popullarizimi të pamjaftueshëm e të ndonjë qëndrimi jodashamir, nuk janë aq të njohura sa meritojnë të jenë edhe për anëtarët e Alb-Shkencës.

I. PROGRAMI KOMPJUTERIK PËR DREJTSHKRIMIN E GJUHËS SHQIPE AS 2.0

Tashmë është në shfrytëzim nga dhjetëra mijëra përdorues. Lënda leksikore e programit është nxjerrë kryesisht nga “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” me rreth 41 mijë fjalë (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980) Vlerësohet se programi mbulon rreth 90% të leksikut të përgjithshëm të shqipes. Programi i ka përballuar me sukses testet për saktësi gjuhësore. Grupi që e ka përgatitur këtë softuer, ka mbledhur ndërkohë materiale të reja për pasurimin e tij, po ashtu ka edhe ndonjë pasaktësi që duhet përmirësuar. Programi do të pasurohet në vijimësi edhe me komponentin sintaksor e sinonimik. Programi përmban një fjalës prej më se 150 mijë fjalësh, të cilat bashkë me fjalëformat e tyre (format e lakimit e të zgjedhimit) arrijnë në mbi 2.300.000 trajta të papërsëritshme fjalësh. Programi bën mbi 5 milionë korrigjime automatike për dy grupe kryesore gabimesh:

1) Gabime që rrjedhin nga shpejtësia e shkrimit – mund t’i quajmë dhe gabime teknike. Një rast i tillë është kur ngatërrohen shkronja të afërta në tastierë, p.sh. po të shkruajmë gabimisht *shkrnca*,

shkrnca, *shkenca*, *sidimos* automatikisht në ekran del forma e drejtë *shkenca*, *sidomos*. Raste të tilla janë me dhjetëra.

2) Gabime që rrjedhin nga mosnjohja e rregullave gjuhësore, p.sh. po të shkruajmë *marëveshje*, *psikologji*, *numuroj* automatikisht në ekran dalin trajtat e drejta *marrëveshje*, *psikologji*, *numëroj*. Raste të tilla janë gjithashtu me dhjetëra.

Trajtat e gabuara që programi nuk i korrigjon automatikisht, nënvizohen me një vizë të kuqe të valëzuar. Programi jep sugjerime për trajtat që nuk i njeh si të rregullta, por kryesorja është se ai tërheq vëmendjen, të lajmëron se diçka nuk është në rregull ose ndoshta nuk është në rregull. Programi kthehet kështu edhe në një mësues të zellshëm e të pagabueshëm të gjuhës për të gjithë. Të gjithë kemi nevojë për të. Ai është domosdoshmëri. Por megjithatë nuk duhet kujtuar se ky softuer është si ai shkopi magjik i përrallës, që i kthen në ar sendet që prek. programi është bërë për t’u përdorur, si i thonë fjalës, “me mend në kokë”! Programi nuk është aq “i mençur”, sa të dallojë p.sh. gabime kur dikush shkruan *ruaj* në vend të *rruaj* ose anasjelltas. Programi i njeh si të rregullta të dyja këto trajta. Kujdes duhet pasur veçanërisht kur shkruajmë një tekst shkencor, ku përdoren edhe fjalë të huaja e terma, të cilat ndonjëherë programi i “korrigjon” sipas mënyrës së shqipes, p.sh. nëse në një tekst na duhet të shkruajmë fjalën *doctor* sipas latinishtes dhe gjuhëve të tjera që përdorin këtë formë, programi ynë e “korrigjon” menjëherë në *doktor*. Si duhet vepruar në këto raste? Zgjidhja është e thjeshtë: e shkyçim programin dhe pasi kemi përfunduar tekstin, i bëjmë një kontroll duke aktivizuar programin. Në këtë rast nga trajtat e nënvizuara me të kuqe do të korrigjojmë vetëm trajtat e gabuara, ndërsa fjalët e huaja ose termat e veçantë që programi nuk i njeh, do t’i lëmë siç janë.

II. WINDOWS NË SHQIP

Microsoft Windows XP është tashmë edhe në gjuhën shqipe. Për të vendosur Windows-in në shqip QEP i është dashur të përballojë një punë të madhe si në aspektin inxhinierik, ashtu edhe në aspektin gjuhësor (terminologjik). Kalimi i Windows-it nga anglishtja si gjuhë bazë në një gjuhë

tjetër, në rastin tonë në gjuhën shqipe, nuk është thjesht një përkthim termash, por një përshtatje e përbajtjes së Windows-it në traditën gjuhësore e kulturore shqiptare. Me gjithë përhapjen e madhe të anglishtes, veçanërisht në brezin e ri, Windows shqip, ashtu si në çdo gjuhë tjetër amtare, ka përparësitë e veta në përdorimin e PC-së.

III. KULLA E SHQIPES

Ky është një program mësimor për përvetësimin e mirë të gjuhës shqipe jo vetëm nga të huajt, por edhe nga Shqiptarët. Dihet se sistemi morfologjik i gjuhës shqipe (ashtu si edhe i disa gjuhëve të tjera) është i ndërlikuar, me shumë forma lakimi e zgjedhimi. Programi me emrin simbolik "Kulla e shqipes" përmban shumë tabela për emrin, mbiemrin dhe foljen. Programi është i thjeshtë për t'u përdorur dhe shumë i dobishëm, veçanërisht për nxënësit.

IV. VARIANTI ELEKTRONIK I "FJALORIT TË GJUHËS SË SOTME SHQIPE" (1980)

Është zgjedhur ky fjalor si më i pasuri ndër fjalorët shpjegues të shqipes deri në v. 2005. Fjalori instalohet lehtë dhe është shumë praktik në përdorim. Ky program ka nevojë të pasurohet me lëndën e re leksikore që përmban *Fjalori i gjuhës shqipe* i vitit 2006 dhe të përmirësohen disa shpjegime që mbajnë vulën ideologjike të viteve '80.

Këto katër programe që u paraqitën shkurtimisht për të vënë në dijeni opinionin, sidomos në Shqipëri, ku këto njihen pak, dëshmojnë se, me gjithë vonesën në krahasim me gjuhë të tjera, edhe për gjuhën shqipe janë krijuar tashmë disa programe gjuhësore kompjuterike si mjete pune tepër të dobishme e praktike. Tani është e nevojshme që këto mjete të njihen sa më gjerë dhe të përdoren nga të gjitha ata që punojnë me PC. Alb-Shkenca me autoritetin që po fiton gjithnjë e më shumë, mund të japë një ndihmesë të rëndësishme për të gjallëruar interesimin e administratës shtetërore ndaj këtyre programeve si dhe për të sjellë përmirësimin e zhvillime të reja në këtë fushë.

Prodhimi i softuerëve të sipërpërmendur është organizuar dhe financuar nga Qendra për Edu-

kim dhe Përparim (Prishtinë), e cila ka dhe pronësinë mbi to. Përparimi i kësaj veprimtarie deri në këtë fazë është mbështetur në interesimin/kontratën për blerje/licensim të këtyre softuerëve nga Qeveria e Kosovës, e cila i ka futur në përdorim, po ashtu Ambasada e SHBA në Kosovë e Shqipëri, OSBE, KFOR dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë nga vende ku praktika e pagesës për përdorimin e një produkti është një normë e rrënjësor dhe e padiskutueshme.

Në Shqipëri ka blerje të herëpashershme nga qytetarë ose ndonjë organizatë private. Por, mjerisht, nuk ka pasur ndonjë ndihmë financiare apo sponsorizim nga qeveria. Për më tepër nuk ka pasur ndonjë kontratë për blerje/licencim të tyre nga Qeveria e RSH ose ndonjë institucion qeveritar tjetër. Megjithatë ka mijëra instalime të paautorizuara (ka plot fakte e dëshmi) nëpër institucione qeveritare dhe përdorim piratesk. Nga faqja zyrtare e QEP-it deri sot ka pasur mbi 150.000 shkakime të këtyre softuerëve; mbi 50.000 shkakime janë në territorin e Shqipërisë, çka lë të kuptohet se ka mbi 50.000 instalime brenda Shqipërisë. Është e domosdoshme që këto programe t'i kenë e t'i përdorin të gjitha shkollat publike e jopublike, institucionet botuese të shtetit e private.

Mungesa e deritashme e realizimit të një marrëveshje me Qeverinë e Shqipërisë për t'i blerë dhe zyrtarizuar këta softuerë të veçantë, e pengon përparimin e tyre dhe kjo është arsyeja kryesore pse QEP tash tre vjet nuk ka bërë përditësimin e tyre, qoftë shtimin e fjalëve, qoftë prodhimin e komponenteve të tjera, siç janë komponenti gramatikor dhe sinonimik. Kohët e fundit Qeveria e Shqipërisë ka bërë licensimin (blerjen e licencave) për softuerët e Microsoft-it, siç janë Windows dhe Office, dhe kjo shton shpresën që edhe softuerët e QEP-it të blihen dhe shfrytëzohen në mënyrë të ligjshme edhe nga Qeveria e Shqipërisë ashtu siç ka vepruar Qeveria e Kosovës. QEP është në kontakt me qeverinë e Shqipërisë, por gjërat ecin shumë ngadalë. Janë të gjitha mundësitë që, kur të ketë gatishmëri për një marrëveshje me Qeverinë e Shqipërisë edhe Alb-Shkenca të përfshihet në avancimin e këtyre softuerëve në çdo formë të mundshme qoftë edhe duke fituar të drejta pronësie.